



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1 Shkodër,

web: www.bashkiashkoder.gov.al

e-mail: keshillibashkiak@bashkiashkoder.gov.al

V E N D I M

Nr. 43, datë 30.6.2017

Mbi dhënien e ndihmës financiare dhe miratimin e vlersimit të dëmeve për dëmet e shkaktuara nga zjarri, për familjet Hoxha

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 30.06.2017, me propozim të kryetarit të bashkisë, mbështetur në nenin 8, 9, 40, nenin 54 shkronja "dh", nenin 55 pika 3 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", VKM nr. 329 datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtari njerëzore", udhëzimi i përbashkët i Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financave nr. 263 datë 24.05.2013 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", VKB nr 23, datë 30.3.2017 "Për dhënien e ndihmës financiare për familjet që kanë pësuar dëme të shkaktuara nga zjarri, VKB nr.8, datë 30.1.2017 "Për buxhetin e bashkisë Shkodër për vitin 2017", me 26 vota pro,

V E N D O S I :

1. Miratimin e vlerës së dëmit nga ana ndërtimore dhe orendi, mobilje e paisje elektroshtepiake sipas preventivave të komisionit të vlersimit të dëmeve pranë këshillit të qarkut Shkodër për familjen **Hasije, Ilirjan Haki Hoxha**, në shumën **1,855,772 lekë** (një milion tetëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e dy), e pasqyruar edhe në relacionin nr. 2513/b prot, datë 23.6.2017.
2. Ti propozojë Ministrisë së Punëve të Brendshme akordimin e vlerës prej **1,855,772 lekë** për familjen **Hasije, Ilirjan Haki Hoxha**, meqenëse Bashkia Shkodër nuk posedon fonde për këtë qëllim.
3. Miratimin e vlerës së dëmit nga ana ndërtimore dhe orendi, mobilje e paisje elektroshtepiake sipas preventivave të komisionit të vlersimit të dëmeve pranë këshillit të qarkut Shkodër për familjen **Ruzhdi, Djana Hoxha**, në shumën **2,272,128 lekë** (dy milion e dyqind e shtatëdhjetë e dy mijë e njëqind e njëzet e tetë), e pasqyruar edhe në relacionin nr. 2513/b prot, datë 23.6.2017.

4. Ti propozojë Ministrisë së Punëve të Brendshme akordimin e vlerës prej **2,272,128 lekë** për familjen **Ruzhdi, Djana Hoxha**, meqenëse Bashkia Shkodër nuk posedon fonde për këtë qëllim.
5. Miratimin e vlerës së dëmit nga ana ndërtimore dhe orendi, mobilje e paisje elektroshtepiake sipas preventivave të komisionit të vlersimit të dëmeve pranë këshillit të qarkut Shkodër për familjen e **Xhelal Hoxha**, në shumën **1,789,150 lekë** (një milion e shtatëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e pesëdhjetë), e pasqyruar edhe në relacionin nr. 2513/b prot, datë 23.6.2017.
6. Ti propozojë Ministrisë së Punëve të Brendshme akordimin e vlerës prej **1,789,150 lekë** për familjen e z. **Xhelal Hoxha**, meqenëse Bashkia Shkodër nuk posedon fonde për këtë qëllim.
7. Miratimin e vlerës së dëmit nga ana ndërtimore dhe orendi, mobilje e paisje elektroshtepiake sipas preventivave të komisionit të vlersimit të dëmeve pranë këshillit të qarkut Shkodër për familjen e z. **Merzuk Hoxha**, në shumën **2,299,238 lekë** (dy milion e dyqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e tridhjetë e tetë), e pasqyruar edhe në relacionin nr. 2513/b prot, datë 23.6.2017.
8. Ti propozojë Ministrisë së Punëve të Brendshme akordimin e vlerës prej **2,299,238 lekë** për familjen e z. **Merzuk Hoxha**, meqenëse Bashkia Shkodër nuk posedon fonde për këtë qëllim.
9. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
10. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Miratuar në datën 30.6.2017
Shpallur në datën 30.6.2017

Sekretar i këshillit


Suel Hadri

KRYETAR

Xhemal BUSHATI
